



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.235/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Ferki Xhaferi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkritazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-Partia Social Demokrate (AAK-PSD), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë.06.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Pranohen të bazuara ankesat e evidentuara si: Anr.235/2019, Anr. 236/2019, Anr.245/2019, Anr.247/2019, Anr.250/2019, Anr.266/2019, të gjitha të datës 05.10.2019, të paraqitura nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, dhe subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, për shkak të vazhdimit të sponsorimit të fushatës zgjedhore në rrjetin social “Facebook”, në ditën e heshtjes zgjedhore i Shqiptohet gjobë, në lartësi prej 3.000.00 (tre mijë) euro, dhe Detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

Me datë 05.10.2019, PZAP-i ka pranuar ankesat Anr.238/2019, Anr.241/2019, Anr.246/2019, Anr.249/2019, Anr.252/2019, Anr.256/2019, 259/2019, Anr.260/2019, Anr.265/2019, Anr.268/2019, dhe Anr.266/2019, nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-Partia Social Demokrate (AAK-PSD), me seli në Prishtinë, në të cilat pretendon se përmes Facebook Ad Library, në llogarinë zyrtare në facebook të koalicionit AAK-PSD dhe në llogaritë zyrtare në facebook të kandidatëve për deputet nga radhët e këtij subjekti politik, respektivisht në llogarinë e kandidatëve: Ramiz Llugaxhiu, Driton Bardheci, Pal Lekaj, Donika Kadaj-Bujupi, Bajram Hasani dhe Muhamet Kelmendi, ka bërë fushatë në rrjetin social Facebok, në ditën e heshtjes zgjedhore dhe në ditën e votimit. Me këtë rast paraqitësi i ankesës thekson se është bërë shkelje e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Parashtruesi i ankesave si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara në cilësi të provave materiale.

Në përgjigjet në ankesë të ofruar nga koalicioni AAK-PSD deklarojnë se ankesat e bëra në fjalë, nuk ceket saktësisht se cilin nen të ligjit ose cilin paragraf e shkel ky lloj marketingu aktiv që e ka parashtruar ankuesi dhe vlerëson se ankesa është e pabazuar dhe si e tillë lusin PZAP-in, të hedhin poshtë.

PZAP-it, i propozon që gjatë vendimmarrjes të marrë për bazë faktin se koalicioni AAK-PSD, e ka përmbushur obligimin ligjor ashtu që i ka njoftuar të gjithë kandidatet dhe mbështetësit e subjektit politik, me Kodin e mirësjelljes, si dhe me Rregulloren Nr.11/2013 neni 3 3.3, 3.4 dhe 3.6.

Koalicioni AAK-PSD, përgjigjes në ankesë, si provë i ka bashkangjitur njoftimin e bërë në rrjetet sociale, për anëtarët dhe simpatizantët e tij lidhur me respektimin e rregullave zgjedhore.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale - fotografive të bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesat janë të bazuara

Paneli paraprakisht ka vlerësuar se ankesat: Anr.235/2019, Anr.236/2019, Anr.245/2019, Anr.247/2019, Anr.250/2019 dhe Anr.266/2019, të gjitha të datës 05.10.2019, janë për nga përmbajtja të njëjta, për nga natyra e shkëljes së pretenduar janë të njëjta, paraqitës i të gjitha ankesave është Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, dhe poashtu të njëjtat janë paraqitur kundër subjektit të njëjtë politik, respektivisht koalicionit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-Partia Social Demokrate (AAK-PSD), me seli në Prishtinë, prandaj Paneli bazuar në nenin 8 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vendimmarrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të trajtohen me një vendim”*, andaj Paneli bëri bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga shkresat e lëndës shihet se si koalicioni AAK-PSD dhe kandidatët e tyre për deputetet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e koalicionit, gjatë heshtjes zgjedhore dhe ditës së votimit në rrjetin e saj social facebook kanë bërë fushatë zgjedhore dhe kanë udhëzuar që të votohet koalicioni i tyre dhe kandidatët e koalicionit në fjalë, ku me këtë veprim ka bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Paneli, konform dispozitës në nenin 8 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 02/2015, ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës, dhe gjeti se të njëjtat janë të bazuara, për faktin se në llogaritë e Facebook-ut të lartëcekura, ashtu siç pretendon paraqitësi i ankesës, në ditën e heshtjes zgjedhore dhe në ditën e votimit janë hasur reklama politike aktive, të cilat promovojnë subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dhe kandidatët për deputet nga radhët e këtij subjekti politik, ku me këtë veprim kanë bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Paneli, vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse, konform nenit 117 par.3 të LZP-së, andaj nuk i mori parasysh pretendimet e paraqitësit të përgjigjes në ankesë, pasi që nga ana e tyre nuk u ofrua ndonjë dëshmi e cila argumenton pretendimet e tyre.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-Partia Social Demokrate (AAK-PSD), me seli në Prishtinë, është përgjegjës për veprimet e tija, pasi që me veprimet e lartcekura ka shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku thuhet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.

Paneli mbi bazën e të dhënave të lartcekuar në mbështetje të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.235/2019 më datë 06.10.2019

Kryesues i Panelit
Adnan Konushevc



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.